REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 1535/10 prot. Tiranë, më 28.10.2026

V E N D I M

Nr. 45, datë 28.10.2026

PËR

ZBATIMIN E MASAVE ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 4, 5, 6 dhe 7, pikës 1 dhe shkronjave "c", "dh", "e" dhe "f" të pikës 2 të nenit 9/1 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar,

KONSTATOHET SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit"), në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2025 dhe rekomandimet për vitin 2026", në përmbushje të Programit të Punës për vitin 2026, si dhe referuar Planit të Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Transparencës Proaktive për vitin 2026, ka kryer verifikimin e përmbushjes së detyrimeve lidhur me publikimin dhe përditësimin e informacionit në Programin Institucional të Transparencës së Autoritetit Publik "Bashkia Dimal" (në vijim "Autoriteti Publik").

Autoriteti Publik i ushtron kompetencat e tij bazuar në dispozitat e ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar. Në pikën 1 të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar (në vijim "LDI"), përcaktohet se: *""Autoritet publik": a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli,* ***organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli****, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës "c" të kësaj pike".* Për rrjedhojë, Bashkia Dimal konsiderohet autoritet publik në kuptim të LDI-së.

Në pikën 1 të nenit 4 të LDI-së parashikohet se: *"Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni".* Në pikën 3 të nenit 4 të LDI-së përcaktohet se: *"Programi i transparencës bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik".* Ndërsa, në nenin 6 të LDI-së parashikohet se: *"Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike..."*.

Neni 8 i LDI-së përcakton se: *"1. Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet jo më pak se 1 (një) herë në muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër. 2. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos standarde për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit".*

Bazuar në nenin 6 të LDI-së, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") ka nxjerrë Urdhrin nr. 281, datë 30.12.2025 "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore" (në vijim "Urdhri nr. 281/2025"). Urdhri nr. 281/2025 është një akt nënligjor, i cili është publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 6, datë 08.01.2026.

Bazuar në nenin 8 të LDI-së, Komisioneri ka nxjerrë Urdhrin nr. 188, datë 18.12.2020 "Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar" (në vijim "Urdhri nr. 188/2020"). Urdhri nr. 188/2020 është një akt nënligjor, i cili është publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 224, datë 22.12.2020.

Referuar sa më sipër, si dhe bazuar në Planin e Mbikëqyrjes së Transparencës Proaktive të Autoriteteve Publike për vitin 2026, miratuar me shkresën nr. 630 prot., datë 27.02.2026, Zyra e Komisionerit dërgoi pranë Autoritetit Publik Urdhrin nr. 125, datë 05.06.2026 "Për kryerjen e hetimit administrativ", me objekt:

- *Përmbushja e detyrimit për vënien në dispozicion të publikut në faqen zyrtare të autoritetit publik, kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë, bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.*
- *Përmbushja e detyrimit për vënien në zbatim të Programit Institucional të Transparencës sipas modelit të miratuar me Urdhrin nr. 281/2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore".*

Referuar shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 7 të LDI-së, regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve është një nga dokumentet/rubrikat e përfshira në publikimin e Programit Institucional të Transparencës. Më datë 16.06.2026, grupi i punës i Zyrës së Komisionerit u paraqit pranë Autoritetit Publik, i cili është njoftuar paraprakisht edhe nëpërmjet komunikimit elektronik në datën 12.06.2026 për zhvillimin e procedurës së hetimit administrativ. Gjatë hetimit administrativ në mjediset e Autoritetit Publik nuk ishte i pranishëm titullari i kësaj njësie të vetëqeverisjes vendore (në cilësinë e personit përgjegjës për Programin e

Transparencës), por në bazë të urdhrit të delegimit për nënshkrimin e akteve u paraqit znj. Rajmonda Shuka, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, si dhe znj. Rabushe Hoxha, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, e caktuar si koordinatore për të drejtën e informimit (në cilësinë e personit përgjegjës për regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve). Grupi i punës, sipas procesverbalit nr. 1535/2 prot., datë 16.06.2026, konstatoi se Autoriteti Publik nuk kishte përmbushur detyrimet për publikimin dhe/ose përditësimin e informacionit në Programin Institucional të Transparencës, sipas parashikimeve të LDI-së dhe Urdhrit nr. 281/2025. Gjithashtu, grupi i punës konstatoi se koordinatori për të drejtën e informimit nuk mbante, përditësonte dhe publikonte regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të LDI-së dhe modelit të miratuar me Urdhrin nr. 188/2020 të Komisionerit. Për rrjedhojë, regjistri nuk rezultonte i afishuar në mjediset e Autoritetit Publik. Përfaqësuesit e Autoritetit Publik deklaruan se do të angazhoheshin për përmbushjen e detyrimeve ligjore për Programin e Transparencës dhe regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, duke evidentuar njëkohësisht problematikën teknike në aksesimin dhe administrimin e faqes zyrtare të internetit të Bashkisë Dimal, në lidhjen https://bashkiadimal.gov.al/.

Autoriteti Publik, nëpërmjet komunikimeve elektronike të datave 14.06.2026 dhe 17.06.2026, ka informuar Zyrën e Komisionerit mbi situatën për administrimin/aksesimin e faqes zyrtare, duke vënë në dispozicion kopje të shkëmbimit të *email*-eve me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Edhe nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 28.06.2026, Bashkia Dimal konfirmon të njëjtën problematikë.

Zyra e Komisionerit monitoroi *online* faqen zyrtare të Bashkisë Dimal, më datë 06.08.2026, dhe konstatoi se Autoriteti Publik nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në nenin 7 të LDI-së, për publikimin e informacionit/dokumentacionit në Programin Institucional të Transparencës dhe të strukturuar sipas modelit të miratuar me Urdhrin nr. 281/2025 të Komisionerit. Njëkohësisht, u konstatua se regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve nuk ishte publikuar në faqen zyrtare sipas modelit të miratuar me Urdhrin nr. 188/2020 të Komisionerit. Në këto kushte, me qëllim ushtrimin e së drejtës për t'u dëgjuar të personave përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në LDI në lidhje me Programin e Transparencës dhe regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, me shkresën nr. 1535/4 prot., datë 06.08.2026, Komisioneri njoftoi zhvillimin e një seance dëgjimore, e parashikuar për t'u mbajtur në datën 17.08.2026.

Seanca dëgjimore u zhvillua me qëllim garantimin e së drejtës të personave përgjegjës për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur qëndrimet, argumentet dhe/ose provat e tyre përpara marrjes së vendimit përfundimtar, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon se: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", si dhe nenet 87 dhe 88 të këtij Kodi.

Seanca dëgjimore e datës 17.08.2026 u zhvillua në mungesë të personave të njoftuar, përkatësisht titullares së Autoritetit Publik, në cilësinë e personit përgjegjës për Programin e Transparencës, dhe koordinatores për të drejtën e informimit, përgjegjëse për regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve. Znj. Rabushe Hoxha, në cilësinë e

koordinatores për të drejtën e informimit, njoftoi nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 17.08.2026 pamundësinë për të marrë pjesë në seancë për arsye shëndetësore, duke paraqitur raport mjekësor për paaftësi në punë.

Duke marrë në konsideratë rrethanat e paraqitura, Zyra e Komisionerit njoftoi nëpërmjet shkresës nr. 1535/6 prot., datë 17.08.2026, zhvillimin e një seance të dytë dëgjimore, të caktuar për në datën 21.08.2026, me qëllim garantimin e së drejtës së personave përgjegjës për t'u dëgjuar përpara marrjes së vendimit përfundimtar. Edhe kjo seancë e dytë dëgjimore u zhvillua pa praninë e personave të thirrur, ku, përsëri, znj. Rabushe Hoxha njoftoi nëpërmjet komunikimit elektronik mungesën e saj për arsye shëndetësore, por pa bashkëlidhur ndonjë dokument.

Zyra e Komisionerit, ndërkohë, monitoroi *online* faqen zyrtare të Bashkisë Dimal, në datat 17.08.2026 dhe 21.08.2026, duke konstatuar vijimin e mospërmbushjes së detyrimeve ligjore, për publikimin dhe përditësimin e informacionit në Programin Institucional të Transparencës dhe për regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, shkak për të cilin edhe u iniciua zhvillimi i kësaj procedure administrative.

Nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 01.09.2026, Autoriteti Publik njoftoi Zyrën e Komisionerit se kishte rifituar aksesin në faqen zyrtare të internetit dhe se po vijonte punën për përmbushjen e detyrimeve ligjore, pa përcaktuar një afat konkret për përfundimin e këtij procesi. Megjithatë nga monitorimi i kryer në datën 14.09.2026 rezultoi se Autoriteti Publik vijonte të mos kishte përmbushur detyrimet ligjore lidhur me Programin Institucional të Transparencës dhe regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve.

Në këto kushte, me shkresën nr. 1535/8 prot., datë 18.09.2026, duke marrë në konsideratë vijimin e mospërmbushjes së detyrimeve dhe mungesën e personave përgjegjës në të dyja seancat dëgjimore, si dhe faktin se personat përgjegjës sipas nenit 19 të LDI-së nuk u paraqitën në asnjërën prej dy seancave dëgjimore të zhvilluara për këtë qëllim, Zyra e Komisionerit, përpara përfundimit të procedurës administrative, iu dha një mundësi shtesë të paraqisnin me shkrim sqarimet, argumentet dhe/ose provat e tyre lidhur me shkeljet e konstatuara, brenda datës 23.09.2026. Kjo masë u ndërmor për të garantuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur shpjegime e prova përpara marrjes së vendimit përfundimtar, në përputhje me nenet 10, 47 dhe 87 të Kodit të Procedurave Administrative. Brenda afatit të përcaktuar, Zyra e Komisionerit nuk mori përgjigje nga asnjëri prej personave përgjegjës.

Referuar Urdhrit nr. 281/2025 të Komisionerit, njësitë e vetëqeverisjes vendore kishin afat deri në datën 31.03.2026 për të reflektuar ndryshimet dhe për të bërë përshtatjen e Programit Institucional të Transparencës sipas modelit të miratuar në lidhjen nr. 1 bashkëlidhur Urdhrit. Bashkia Dimal ishte njoftuar për këtë detyrim dhe afatin përkatës nëpërmjet shkresës nr. 72 prot., datë 09.01.2026.

E drejta për informim garantohet nga neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Një nga instrumentet kryesore për garantimin e kësaj të drejte është Programi Institucional i Transparencës, përmes të cilit autoritetet publike vënë në dispozicion të publikut, pa kërkesë paraprake, informacionin e përcaktuar në ligj. Për këtë arsye, Autoriteti Publik ka detyrimin jo vetëm të publikojë Programin e Transparencës, por edhe

të sigurojë plotësimin dhe përditësimin e informacionit sipas kategorive dhe nënkategorive përkatëse, në formate lehtësisht të aksesueshme dhe në përputhje me nenin 7 të LDI-së dhe modelin e miratuar nga Komisioneri.

Komisioneri vlerëson se problematika teknike e raportuar nga Autoriteti Publik lidhur me aksesimin e faqes zyrtare është marrë në konsideratë gjatë procedurës administrative, duke i dhënë autoritetit kohë shtesë për përmbushjen e detyrimeve. Megjithatë, kjo rrethanë nuk mund të justifikojë vijimin e mospërmbushjes së detyrimeve ligjore edhe pas rikthimit të aksesit në faqen zyrtare, të konfirmuar nga vetë autoriteti publik më datë 01.09.2026, veçanërisht në kushtet kur detyrimet vijuan të rezultonin të papërmbushura edhe nga monitorimet e mëvonshme.

Zyra e Komisionerit, nga verifikimet e kryera deri në datën e nxjerrjes së këtij vendimi, konstatoi se Autoriteti Publik vijon të mos ketë publikuar në faqen zyrtare të internetit në lidhjen https://bashkiadimal.gov.al/ informacionin/dokumentacionin në kategoritë/ nënkategoritë e Programit të Transparencës, në përputhje me nenin 7 të LDI-së dhe sipas modelit/formatit të Urdhrit nr. 281/2025 të Komisionerit. Konkretisht, konstatohet mungesa e informacionit dhe përditësimit të tij lidhur me organizimin dhe funksionimin e Bashkisë, me të dhënat mbi transparencën dhe llogaridhënien ekonomiko-financiare, mbi informacionin lidhur me procedurat e prokurimit publik, mbi legjislacionin dhe aktet rregullatore, të dhënat mbi konsultimin publik, të dhënat mbi procesin e integrimit evropian, shoqërisë civile e strukturave komunitare, si dhe informacionit lidhur me veprimtarinë e Këshillit Bashkiak. Gjithashtu, rezultoi se regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve vijonte të ishte i papublikuar në faqen zyrtare, në kundërshtim me detyrimin e përcaktuar në nenin 8 të LDI-së dhe Urdhrin nr. 188/2020 të Komisionerit.

Pika 1 e nenit 18 të LDI-së parashikon se: "*Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni*", konkretisht: *"Shkronja "ç/1", mospublikimi i akteve brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të nenit 7 dhe mospërditësimi i kategorive të informacionit të Programit Institucional të Transparencës sipas pikës 4 të nenit 7 të këtij ligji dënohet me 25 000 deri në 50 000 lekë"*.

Në pikën 1 të nenit 19 të LDI-së parashikohet se: *"Titullari i autoritetit publik mban përgjegjësi ligjore-administrative për shkelje administrative të parashikuara në ... shkronjën "ç/1" të pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji"*. Referuar këtyre parashikimeve ligjore dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, përgjegjësia ligjore-administrative për shkeljet e konstatuara lidhur me Programin Institucional të Transparencës i atribuohet znj. Juliana Memaj, Kryetar i Bashkisë Dimal.

Po ashtu, sipas shkronjës "d" të pikës 2 të nenit 18 të LDI-së, parashikohet se: *"Moskrijimi, mosmbajtja, mospublikimi apo mospërditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të nenit 8 të këtij ligji, dënohet me 25 000 deri në 100 000 lekë"*. Në pikën 3 të nenit 19 të LDI-së parashikohet se: *"Koordinatori për të drejtën e informimit ka përgjegjësi administrative për shkeljet administrative të parashikuara në shkronjën "d" të pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji"*. Referuar këtij parashikimi ligjor dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit

administrativ, përgjegjësia ligjore-administrative për shkeljen e konstatuar lidhur me Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve i atribuohet znj. Rabushe Hoxha, koordinator për të drejtën e informimit pranë Bashkisë Dimal.

Në përfundim, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të hetimit administrativ dhe rezultatet e monitorimeve të faqes zyrtare të internetit të Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se mosrespektimi i detyrimeve për publikimin dhe përditësimin e informacionit në Programin Institucional të Transparencës, si dhe mospublikimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, përbëjnë kundërvajtje administrative të parashikuara në shkronjat "ç/1" dhe "d" të pikës 2 të nenit 18 të LDI-së, për të cilat përgjegjësia ligjore-administrative i atribuohet përkatësisht titullarit të autoritetit publik për Programin e Transparencës dhe koordinatorit për të drejtën e informimit për regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve. Në përputhje me nenin 19 të LDI-së, përgjegjësia ligjore-administrative për këto shkelje i atribuohet znj. Juliana Memaj, Kryetare e Bashkisë Dimal, për Programin Institucional të Transparencës, dhe znj. Rabushe Hoxha, koordinatore për të drejtën e informimit, për regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve.

Në lidhje me znj. Juliana Memaj, në përcaktimin e masës së gjobës, Komisioneri ka marrë në konsideratë vijimin e mospërmbushjes së detyrimeve ligjore, pavarësisht afateve dhe mundësive të dhëna gjatë procedurës administrative për korrigjimin e mangësive. Është vlerësuar gjithashtu fakti se detyrimet vijuan të mbeteshin të papërmbushura edhe pas rikthimit të aksesit në faqen zyrtare të internetit, të konfirmuar nga vetë Autoriteti Publik më datë 01.09.2026. Në përcaktimin e masës administrative ndaj znj. Juliana Memaj, duke marrë parasysh këto rrethana, natyrën dhe vijimësinë e shkeljes, si dhe parimin e proporcionalitetit, Komisioneri çmon se vendosja e gjobës në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë është e përshtatshme dhe e justifikuar.

Në lidhje me znj. Rabushe Hoxha, në përcaktimin e masës administrative, Komisioneri ka marrë në konsideratë vijimin e mospërmbushjes së detyrimit për publikimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, pavarësisht mundësive të dhëna gjatë procedurës për përmbushjen e tij. Gjithashtu është vlerësuar historiku i shkeljeve, duke iu referuar Vendimit nr. 22, datë 28.10.2024, të Komisionerit, me të cilin është konstatuar më parë shkelja e të njëjtit detyrim ligjor nga personi përgjegjës. Në vlerësim të këtyre rrethanave dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit, Komisioneri çmon se vendosja e gjobës në masën 50 000 lekë përbën një masë të përshtatshme në raport me shkeljen e konstatuar.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjën "dh" të pikës 2 të nenit 9/1, në shkronjat "ç/1" dhe "d" të pikës 2 të nenit 18, në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, 23 dhe 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar, Komisioneri,

V E N D O S I:

1. Autoriteti Publik "Bashkia Dimal", në zbatim të shkronjave "a", "b" dhe "c" të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, të vërë në zbatim, të publikojë, të pasqyrojë, të përditësojë dhe të ndërlidhë në Programin Institucional të Transparencës, në përputhje me nenin 7 të LDI-së dhe duke pasur në konsideratë kufizimet e nenit 17 të tij, informacionin dhe dokumentacionin sipas formatit të Urdhrit nr. 281, datë 30.12.2025 "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda datës 13.11.2026.
2. Dënimin e znj. Juliana Memaj, Kryetar i Bashkisë Dimal, në cilësinë e personit përgjegjës për Programin e Transparencës, për kundërvajtjen administrative të parashikuar në shkronjën "ç/1" të pikës 2 të nenit 18 të LDI-së, me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
3. Koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik "Bashkia Dimal" të krijojë, të mbajë, të publikojë dhe të përditësojë regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, bazuar në pikën 1 të nenit 8 të ligjit "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, dhe sipas modelit të Urdhrit nr. 188, datë 18.12.2020 "Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuara", brenda datës 13.11.2026.
4. Dënimin e znj. Rabushe Hoxha, në cilësinë e koordinatorit për të drejtën e informimit pranë Bashkisë Dimal dhe si person përgjegjës për regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, për kundërvajtjen administrative të parashikuar në shkronjën "d" të pikës 2 të nenit 18 të LDI-së, me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
5. Masat e dënimit me gjobë shlyhen me këste mujore. Gjobat ekzekutohen nga zyra e financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të këtij vendimi.
6. Kundër vendimmarrjes në pikat 1 dhe 3, Autoriteti Publik ka të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas nenit 18 të ligjit "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar, si dhe nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.
7. Kundër vendimmarrjes në pikat 2 dhe 4, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, personat ndaj të cilëve janë vendosur sanksionet administrative (gjoba) kanë të drejtë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bëjnë ankim në gjykatë në përputhje me ligjin nr. 10279/2010 "Për kundërvajtjet administrative".

Ky Vendim u shpall sot, më datë 28.10.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi